



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Ligjislatura V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 19.02.2016, në orën 18:10

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

PROCESVERBAL
të mbledhjes së jashtëzakonshme

Në mbledhje morën pjesë: Agim Qeku, nënkryetar i parë, Agim Kikaj, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Veton Berisha, Milka Vuletiq i Danush Ademi, anëtarë.

Munguan: Jasmina Zhivković, kryetare, Mufera Sinik, nënkryetar i dytë, Sasha Millosavljeviq, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, anëtarë.

Stafi mbështetës: koordinator i Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Agim Qeku, nënkryetar i parë i komisionit

Në mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L- 237 dhe Ligjin nr. 05/L-68 me amendamentet e Komisionit funksional për buxhet dhe finansa

Nënkryetari – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje dhe mbledhja vazhdoi me shqyrtimin i pikës së dytë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-68 me amendamentet e Komisionit funksional për buxhet dhe finansa.

Nënkryetari, Agim Çeku - i njoftoi anëtarët e komisionit se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes së Komisionit me pjesëmarrjen e shumicës së nevojshme kualifikuese për vendim-marrje, dhe bëri disa vërejtje hyrëse mbi këtë çështje, dha sqarime për Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kështu i njeiti paraqet një parakusht të rëndësishëm nga ana e Komisionit Evropian, për çështjen e liberalizimit të regjimit të vizave, dhe se është e nevojshme për miratim me procedurë të përshpejtuar në seancën e sotshme plenare. Gjithashtu, edhe Komisioni funksional në detaje e ka shqyrtuar Projektligjin dhe sesikomisioni përgjegjës ka përgatitur një raport me amendamentet që komisioni duhet të shqyrtoj në aspektin e drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Personalisht unë nuk kam asnjë vërejtje në amendamentet e Komisionit funksional, dhe unë besoj se ato nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe se ato duhet të miratohen pa kundërshtime. Megjithatë, unë ftoj pjesëmarrësit e tjerë të shprehin mendimet e tyre dhe të japin rekomandime për miratimin e këtij ligji në parlament.

Qerim Bajrami: Sot po shqyrtojmë ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji me procedurë të përshpejtuar, andaj kjo nuk është kontestuese, mirëpo kjo nuk do të thotë që të miratojmë të gjitha amendamentet një nga një. Fjala është për amendamentin 2, nën 100 të Komisionit funksional dhe propozoj plotësimin e nën 100, paragrafi 2, si në vijim:

..Qeveria i propozon së paku 2 kandidatë për pozitën e lirë ROJN dhe së paku 2 kandidatë për secilën pozitë të lirë të ROJN-it duke pasur parasysh përfaqësimin nacional dhe gjinor të kandidatëve dhe teksti vazhdon pa ndryshime.

Në pajtim me procedurën e punës së Komisionit, kryetari i hodhi në votim dy propozime të ndryshme:

1. Propozim amendamenti 2 në nën 100, paragrafi 2 të Komisionit funksional për buxhet dhe financa
2. Propozim plotësimi i amendamentit 2 paragrafi, nën 100 të deputetit Qerim Bajrami.

Pas rezultatit të votimit: Për: 4 Kundër: 1 të përmbajtur: 2, kryetari konstatoi se miratohet propozimi amendamenti i Komisionit funksional dhe nxori këtë;

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik i Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-68 nuk i shkel dhe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Amendamentet e propozuara të Komisionit funksional për buxhet dhe financa nuk i shkelin dhe nuk i cenjnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, andaj i rekomandohet Kuvendi që të miratojë këtë projektligj.

Mbledhja përfundoi në orën 19:05

,Njësia për komisione parlamentare

Nënkryetari i Komisionit,

Agim Çeku